



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Në datën 02. 12. 2016 Mekanizmi Parandalues Nacional (MPN) realizoi vizitë të pa paralajmëruar në Stacionin Policor Kriva Pallankë (dy vizitat paraprake të ekipit të MPN në këtë stacion policor u zbatuan në datën 08. 11. 2011 dhe në datën 30. 01. 2013). Vizita në SP Kriva Pallankë filloi në ora 10:00, ndërsa përfundoi në ora 16:00 (vizita zgjati 6 orë).

Vizita e realizuar në SP Kriva Pallankë rezulton nga mandati i Avokatit të Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional, i parashikuar me Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese dhe Ligjin për Avokatin e Popullit.

Mekanizmi Parandalues Nacional këtë vizitë e zbatoi me përfaqësuesin e Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj dhe përfaqësuesin e Shoqatës për të Drejtën Penale dhe Kriminologji të Republikës së Maqedonisë, në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Ekipi i MPN bëri këqyrje në hapësirat zyrtare dhe magazinat të cilat i ka në dispozicion SP Kriva Pallankë. Nga këqyrja e kryer u konstatua se hapësirat në këtë stacion policor janë në gjendje të keqe materiale, e që në mënyrë plotësuese e vështirëson punën e përditshme të këtij stacioni policor. Përkatësisht, thuaja se në të gjitha hapësirat në të cilat u zbatua këqyrja, ishte evidente prezenca e lagështisë në muret e brendshme dhe inventari i vjetruar dhe i amortizuar.

Në Stacionin Policor Kriva Pallankë nuk zbatohet fare mbikëqyrja, kështu që në këtë drejtim MPN konsideron se në përputhje me rekomandimet e Komitetit për Parandalimin e Torturës në stacionet policore, veçanërisht në hapësirën për marrjen në pyetje të personave duhet të përdoret video-mbikëqyrja me qëllim të rritjes së sigurisë dhe zvogëlimit të rreziqeve të mundshme nga tortura ose lloje të tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Në SP Kriva Pallankë ekzistojnë dy hapësira të cilat janë dedikuar për ndalim, të cilat gjenden dy kate nën tokë në pjesën e bodrumit dhe një hapësirë (e improvizuar) ndihmëse për ndalim të shkurtër. Nëpunësit policorë informuan se dy hapësirat e mëparshme për ndalim tanimë nuk përdoren për atë dedikim, si rezultat i

rekomandimeve të dhëna paraprakisht nga ana e ekipit të MPN, pas dy vizitave të realizuara paraprakisht.

MPN zbatoi këqyrje në hapësirën e improvizuar për ndalim në të cilën në momentin e vizitës ishin vendosur 2 persona, ndërsa personi i tretë, shtetas i huaj, priste në korridor i ulur në një karrige që gjendej fill pranë hapësirës. Së këtejmi, MPN konstatoi se hapësira kishte vetëm një karrige, se nuk ka në dispozicion krevat, e as mjete adekuate për pushim (dyshek, jastëk, batanije, etj.). Në këtë hapësirë të improvizuar, mënyra se si janë vendosur grilat, personin e ndaluar e vënë në pozitë poshtëruese me vet faktin se ai u nënshtrohet shikimeve të vazhdueshme të të punësuarve në stacionin policor Kriva Pallankë, si dhe nga qytetarët e tjerë të cilët kanë qasje në stacionin policor.

Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se kjo hapësirë nuk i plotëson kushtet minimale të parashikuara sipas standardeve ndërkombëtare për ndalimin e personave në stacionet policore. Qëndrimi i MPN është se, në këtë stacion policor, hapësira nuk duhet të përdoret as për ndalime të shkurtra, ndërsa ndalimi duhet të kryhet në stacionin më të afërt policor i cili i plotëson kushtet për ndalim edhe atë deri në periudhën e rinovimit të hapësirave për ndalim.